



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.67/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 29.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, ZL.Anr.67/2025, e datës 26.09.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 26.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se me datë 24 shtator 2025, gjatë transmetimit të emisionit "Zgjedhjet në Koha" në KTV, kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) për kryetar të Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu, ka përdorur një gjuhë të papërshtatshme dhe fyese ndaj kandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), z. Përparim Ramusa. Në deklaratën e tij, z. Aliu e ka quajtur kundër kandidatin "harbut", duke thënë: *"është dashtë me u hjek këta harbuta, se këta kanë qenë harbuta, jo drejtora."*

Kjo deklaratë është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1, pika 11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesës në bazë të pretendimeve të elaboruara në këtë ankesë dhe duke marrë për bazë shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e z. Qemajl Aliu, ka kërkuar nga PZAP, që të nxjerrë vendim me të cilën do të aprovoj si të bazuar ankesën e PDK-së, dhe ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet

e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, t'i shqiptoj dënim me gjobë. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë: Video në CD dhe linku i kësaj pjese të deklaratës:

<https://www.youtube.com/watch?v=GMLPe4SssX0>.

Në përgjigje në ankesë të datës 27.09.2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, theksohet se, personi z. Qemajl Aliu, kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Komunës së Shtimes, gjatë transmetimit të emisionit "Zgjedhjet në Koha", i ka cilësuar ish-drejtorët komunal me termin "harbut". Pretendimi se termi i tillë përbën shkelje të rregullave zgjedhore të parapara në nenin 34 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është i pasaktë. Në pikën 11, të paragrafit 1 të këtij neni, ekziston kërkesa që deklarata të ketë potencial për nxitje të dhunës apo urrejtjes, për të qenë e dënueshme. Termi "harbut" i përdorur nga z. Aliu, sado që mund të tingëllojë si i papërshtatshëm apo i ashpër, nuk i përmbush kriteret ligjore për tu klasifikuar si term me të cilin nxitet dhunë apo urrejtje, si i tillë, termi duhet të vlerësohet varësisht nga ndikimi real i përdorimit të tij në vetë integritetin e procesit zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës -së, në të cilin parashihet që: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Paneli vlerësoi se, janë të pabazuara pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar, se gjatë transmetimit të emisionit "Zgjedhjet në Koha" në KTV, kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) për kryetar të Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu, ka përdorur gjuhë të papërshtatshme dhe fyese ndaj kundërkandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), z. Përparim Ramusa, ku në deklaratën e tij, z. Aliu e ka quajtur kundërkandidatin "harbut", duke thënë: *"është dashtë me u hjek këta harbuta, se këta kanë qenë harbuta, jo drejtora."*

Paneli i vlerësoj se janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në deklaratën e kandidatit të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) për kryetar të Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu, shprehja e përdorur ndaj kundërkandidatit "harbut", duke thënë: *"është dashtë me u hjek këta harbuta, se këta kanë qenë harbuta, jo drejtora."* që sipas fjalorit të Gjuhës Shqipe, termi "harbut" përkufizohet si: "Njeri me sjellje të keqe, i pagdhendur, i ashpër e gojështurur; njeri i vrazhdë e i rëndë." (Shih: Fjalori i Gjuhës Shqipe: <http://www.fjalori.shkenca.org/>), sipas vlerësimit të Panelit, nuk përbën nxitje për dhunë apo provokim për dhunë ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të

dhunës kundër personave tjerë, apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, të njëjtat janë vlerësime politike dhe qëndrime të shprehura në kuadër të fushatës zgjedhore dhe me këtë rast paneli nuk ka gjetur se janë shkelur rregullat zgjedhore në dëm të ndonjë subjekti politik.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Zl.Anr.67/2025 më datë 29.09.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.